



Pranuar / Dorëzuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	18.07.2023	3	viti god year
Organ/Njësia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5272/2023		014



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.818 /2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.818/2023 të datës 06.06.2023 të parashtruar nga

(grup ankuesish) të cilët me autorizim i përfaqëson Avokate nga Podujeva, kundër Komunës së Podujevës, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.818/2023 e datës 06.06.2023 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Nëpunësit civil dhe të punësuar në Komunën e Podujevës, më datë 06.06.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komunës së Podujevës lidhur me kategorizimin e pozitës së tyre të punës në Kategorinë Profesionale 3 gjegjësit Bibliotekist/e, si dhe me kërkesën për kompensim retroaktiv të pagës prej 4 muajve, më saktësisht prej hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës, ndërsa Këshilli më datë 15.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueseve
dhe është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimin me numër protokolli me AE.Nr.13-101/03-0079919/21 të datës 01.09.2021, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare për Biblioteka 4", në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës, me koeficient të pagës gjashtë (6), në Kategorinë Profesional 4, sipas sistemit të vjetër të pagave. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ankuesja është kategorizuar në Kategorinë Profesional 3.

Tutje bazuar në Akt Emërimin me numër protokolli AE.Nr.13-101/03-000799/21 datës 01.09.2021, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Bibliotekës", në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës, me koeficient të pagës gjashtë (6), sipas sistemit të vjetër të pagave. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ankuesi është kategorizuar në Kategorinë Profesional 3.

Bazuar në Akt Emërimin me numër protokolli AE.Nr.13-101/03-0079904/21 të datës 01.09.2021, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Përgjegjës Bibliotekë", në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës, me koeficient të pagës shtatë (7), sipas sistemit të vjetër të pagave. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ankuesi është kategorizuar në Kategorinë Bibliotekist.

Bazuar në Akt Emërimin me numër protokolli AE.Nr.13/101-03-0079909/21 të datës 01.09.2021, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare për Biblioteka 4", me koeficient të pagës gjashtë (6), sipas sistemit të vjetër të pagave. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ankuesja është kategorizuar në Kategorinë Profesional 3.

Më datë 15.03.2023 ankuesit dhe
(grup ankuesish) të cilët me autorizim i përfaqëson Avokate kanë parashtruar kërkesë lidhur me nivelizimin e koeficientit nga niveli Profesional 3 në nivelin Profesional 2 në Komunën e Podujevës, ndërsa të njëjtit nuk kanë pranuar asnjë përgjigje nga kjo e fundit.

Ankuesit të pakënaqur me heshtjen administrative të Komunës së Podujevës me datë 06.06.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Podujevës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me datë 05.02.2023, ka kategorizuar ankuesit në kategorinë Profesional 3,

gjegjësisht në Klasën Bibliotekist, si dhe me kërkesën për kompensim retroaktiv të pagës prej 4 muajve, më saktësisht prej hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Podujevës ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesve në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesve lidhur me kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë *Profesionale 1* është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesve iu lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konflikt administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.818/2023

Kaltrina AVDULLAHI-PRENAJ


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Avokate.
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

